



NJOFTIM

PËR

PJESËMARRJEN NË PROCESIN E “TRAJNIMIT TË VIJUESHËM PROFESIONAL PËR VITIN 2022”, TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM TË CERTIFIKUAR, TË CILËT NUK E USHTROJNË DETYRËN SI “AUDITUES TË BRENDSHËM” NË SEKTORIN PUBLIK

1. Në mbështetje të urdhrin të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.248, datë 31.12.2021 “Për miratimin e Programit të Trajnimit të Vijueshëm Profesional për Audituesit e Brendshëm në sektorin publik për vitin 2022”, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm njofton fillimin e procesit të trajnimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik.
2. Të gjithë individët të cilët zotërojnë certifikatën si “Auditues të Brendshëm“, në sektorin publik, por që nuk e ushtrojnë detyrën si AB në sektorin publik, dhe nëse janë të interesuar për të marrë pjesë në këtë proces me 40 orë/trajnim në vit, duhet të paraqesin pranë DHAB-së, këtë dokumentacion, si vijon:
 - Kërkesë me shkrim, drejtuar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm;
 - Fotokopje të Certifikatës së Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik;
 - Kopje të mandatit të pagesës së tarifës së trajnimit, prej 10.000 lekë.
3. Individët të cilët do të aplikojnë për të marrë pjesë në ‘Trajnimin e Vijueshëm Profesional të Audituesve të Brendshëm për vitin 2022’, dhe plotësojnë të gjitha kushtet e pikës 2, të njoftimit, në zbatim të VKM-së Nr.116, datë 17.02.2016, kreu IV, pika 2, gërma b), do të regjistrohen në një listë të veçantë, si dhe procesin e trajnimit do ta ndjekin së bashku me grupet e audituesve të brendshëm të sektorit publik të cilët ushtrojnë detyrën e AB, sipas kalendarit të miratuar nga struktura përgjegjëse për organizimin e TVP-së.

Dokumentacioni i kërkuar duhet të dorëzohet zyrtarisht në protokollin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Detaje më të hollësishme lidhur me procesin e trajnimit dhe temat e parashikuara në Programin e trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm për vitin 2022, si dhe formatin e miratuar të “Faturës për Arkëtim Tarife të TVP-së v.2022”, i gjeni në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me adresë: www.financa.gov.al.